



Prishtinë, 5 nëntor 2014

DOKUMENT SHPJEGUES

mbi

Arsyet e Mosaplikimit të NQ Gjakova për Tarifat e Sezonit 2014/2015

1. Hyrje

Ky dokument synon të paraqet shpjegimet relevante për arsyet lidhur me mos-aplikimin e NQ Gjakova për tarifat e sezonit të ngrohjes 2014/2015. Në fillim duhet të theksohet se arsyeja kryesore për këtë ka të bëjë me situatën e vështirë financiare aktuale që është pasojë e performancës së dobët operuese dhe ekonomiko-financiare të NQ Gjakovës në sezonët e kaluar. Po ashtu si arsye shtesë janë pasiguritë për subvencionin për lëndën djegëse – mazutin, që vë në pikëpyetje fillimin e këtij sezoni të ngrohjes.

Këto shpjegime janë dhënë më detajisht në vijim të dokumentit.

2. Performanca Operative dhe Ekonomiko-Financiare e NQ Gjakovës

Siç është e ditur, sidomos në dy sezonët e kaluara performanca operuese dhe ekonomiko-financiare e NQ Gjakovës ishte shumë e dobët, që ka ndikuar shumë keq në gjendjen financiare të ndërmarrjes. Kjo paraqet vështirësi mjaft të madhe për të kryer planifikime (parashikime) të mirëfillta për kostot që duhet përfshirë për përcaktimin e të Hyrave të lejuara dhe tarifave, si dhe për sasitë e prodhimit dhe furnizimit me ngrohje.

2.1 Performanca Operuese

Performanca operuese e NQ Gjakovës, në kuptim të prodhimit dhe furnizimit të konsumatorëve me ngrohje (energji termike), ka qenë mjaft e dobët. Për shkak të vështirësive financiare që ka pamundësuar sigurimin e sasive të mjaftueshme të mazutit, prodhimi i energjisë termike ka qenë dukshëm më i vogël nga ai i planifikuar në shqyrtimet përkatëse tarifore. Kjo më tutje ka ndikuar në furnizim të pamjaftueshëm të konsumatorëve me ngrohje - pra përgjithësisht furnizimi ka qenë me ndërprerje të shumta dhe jocilësorë. Si shembull konkret, në sezonin e kaluar 2013/2014 furnizimi me ngrohje ka filluar në fund të nëntorit 2013 dhe ka përfunduar në mes të shkurtit 2014 – pra as 3 muaj të plota. Gjithashtu edhe brenda kësaj periudhe ka pasur ndërprerje të shkurtëra si dhe ngrohja ka qenë jocilësore



Për të ilustruar performancën e dobët të NQ Gjakovës në prodhimin dhe furnizimin e konsumatorëve me ngrohje, në vijim në formë të përmbledhur janë paraqitur të dhënat e mbledhura gjatë monitorimit të sezonës së kaluar 2013/2014.

Furnizimi dhe konsumi i mazutit – sezoni 2013/2014

Në vijim janë paraqitur në formë tabelare të dhënat e monitoruara për furnizimin me mazut dhe konsumin e mazutit gjatë sezonit të kaluar.

Furnizimi me mazut dhe konsumi – NQ Gjakova, sezoni 2013/2014						
		11/2013	12/2013	01/2014	02/2014	Total
1	Sasia e furnizimit me mazut [ton]	87.16	98.56	328.82	56.86	571.40
2	Konsumi i mazutit [ton]	65.89	83.26	288.67	97.01	534.83
3	Rezervat e mazutit në fillim të sezonit [ton]					0
4	Rezervat e mazutit në fund të sezonit [ton]					36.57

Në vijim është dhënë një paraqitje krahasuese e konsumit të lëndës djegëse me sasi të planifikuara:

NQ Gjakova – konsumi i mazutit në sezonin 2013/2014			
Planifikuar [ton]	Realizuar [ton]	Ndryshimi [ton]	Realizimi [%]
2,160	534.83	1,625.17	24.76

Siq mund të vërehet nga të dhënat e lartë përmendura sasia e furnizimit me mazut ka qenë 571 ton, ndërsa konsumi i mazutit 534 ton, që në krahasim me planifikimet (parashikimet) paraqet një realizim prej vetëm 24.76%.

Prodhimi, Furnizimi dhe humbjet në sistem

Mungesa e mjeteve financiare për të siguruar sasi të mjaftueshme të mazutit ka ndikuar në mënyrë zingjyrore në prodhimin e ngrohjes dhe furnizimit me ngrohje.

Në vijim paraqiten të dhënat e mbledhura për prodhimin dhe furnizimin me ngrohje për sezonin e kaluar 2013/2014.

NQ Gjakova Bilanci i energjisë termike – sezoni 2013/2014						
Energjia nga lënda djegëse [MW _T h]	Gjenerimi neto i ngrohjes [MW _T h]	Humbjet e gjenerimit [MW _T h]	Efikasiteti i ngrohësor [%]	Humbjet e shpërndarjes [MW _T h]		Furnizimi [MW _T h]
6,043.58	4,415.78	1,627.80	73.06	1,273.12	28	3,142.66

Prodhimi dhe furnizimi me ngrohje i realizuar në sezonin 2013/2014 është dukshëm më i vogël krahasuar me parashikimet (planifikimet) përkatëse të bëra gjatë shqyrtimeve tarifore të sezoneve të kaluara. Realizimi i prodhimit dhe furnizimit me ngrohje është paraqitur në tabelën vijuese.



Realizimi i prodhimit dhe furnizimit me ngrohje – sezoni 2013/2014			
	Planifikuar	Realizuar	% e Realizimit
Prodhimi neto i ngrohjes [MWh _T]	21,479	4,416	20.56 %
Furnizimi me ngrohje [MWh _T]	18,902	3,143	16.63 %

Duhet të theksohet se në përkeqësimin e përqindjes së realizimit kanë ndikuar edhe rritja e humbjeve të prodhimit dhe në shpërndarje (humbjet në prodhim 26.94% dhe në shpërndarje 28%).

Pra në përgjithësi nga të dhënat e paraqitura në tabelat më lartë vërehet një realizim shumë i vogël i të gjithë parametrave kryesor të operimit të NQ Gjakova, e cila afekton negativisht në paprashikimet përkatëse për përcaktimin e të hyrave të lejuara dhe tarifave. Më konkretisht ndikimi më i madhë është në planifikimin e kostos së mazutit, që paraqet koston kryesore, si dhe në planifikimin e sasive të prodhimit të energjisë termike (ngrohjes) dhe të furnizimit të konsumatorëve me ngrohje. Pra kjo performancë e dobët krijon shpërputhje mes parashikimeve të bazuara në një furnizim të mjaftueshëm dhe gjendjes reale financiare e cila faktikisht nuk mund ti përballoj kostot e tilla. Për më tepër këtë e vështirëson edhe fakti se, për shkak të rrethanave objektive, nuk ka të dhëna të besueshme për shumën e subvencionit që eventualisht do ti ndahet NQ Gjakovës (për gjendjen rreth subvencionit dhe ndikimin në parashikimet tarifore me detajisht në vijim të dokumentit).

2.2 Performanca financiare

Ngjashëm me performancën operuese edhe performanca ekonomiko-financiare e NQ Gjakovës është shumë e dobët, ku indikatorët kryesor janë faturimi dhe arkëtimi, dhe realizimi i tyre ka qenë shumë i ulët, sidomos kjo vlen për realizimin e faturimit.

Në vijim në formë tabelare paraqiten të dhënat përkatëse të monitorimit që janë realizuar në sezonin 2013/2014.

Faturimi dhe Arkëtimi i Pagesave - NQ Gjakova (sezoni 2013-2014)

Sezoni Ngrorës 2013/2014							
	Shtitja e Ngrorjes nga Grupi I Konsumatorëve	Sipërfaqja Ngrorëse [m ²]	Faturuar [Euro]	Arkëtuar [Euro]	Shkalla e Arkëtimit [%]	Borgji [Euro]	Borgji [%]
1	Shtëpijak (Amvisri)	86,598.62	44,868.13	26,627.39	0.59	18,240.74	0.41
2	Komercial dhe Institucional	189,975.68	147,429.27	94,013.79	0.64	53,415.48	0.36
3	Total	276,574.30	192,297.40	120,641.18	0.63	71,656.22	0.37

Siç u tha më lartë dhe nga tabela e mësipërme vërehet se faturimi është dukshëm më i vogël se i planifikuar. Kjo është kryesisht pasojë e mos-faturimit për muajt që nuk ka pasur fare furnizim me ngrohje (sezoni i ngrohjes ka filluar në fund të nëntorit 2013 dhe ka përfunduar në mes të shkurtit 2014), si dhe zbritjet në fatura për ndërprerjet e shpeshta disaditore dhe



për cilësinë e ngrohjes. Nëse i referohemi të ardhurave të lejuara (pra nga shitja e ngrohjes) siç janë përcaktuar në shqyrtimin e fundit tarifor në vlerë prej 1,219,000 € shihet se realizimi i faturimit është rreth 16%.

Poashtu edhe arkëtimi i pagesave nga konsumatorët nuk është i kënaqshëm, ku shkalla e përgjithshme e arkëtitimit për dy grupet e konsumatorëve është rreth 63%.

Faturimi dhe arkëtimi i ulët kanë ndikim direkt në situatën e vështirë financiare në të cilë aktualisht gjendet NQ Gjakova. Mungesa e mjeteve financiare të mjaftueshme për mbuluar shpenzimet e operimit, pamundëson në rradhë të parë sigurimin e mazutit në sasi të mjaftueshme për një furnizim të qëndrueshëm me ngrohje. Për këtë, mundësitë shumë të kufizuara financiare për të mbuluar kostot operative, e sidomos koston e furnizimit me mazut, e pamundësojnë një parashikim të saktë të bazuar në mundësitë reale financiare (që janë shumë të limituara) për të mbuluar kostot përkatëse. Vështirësi shtesë paraqesin edhe qështjet e ndërlidhura me subvencionin për lëndë djegëse, që janë shpjeguar më poshtë.

Subvencionet

Për shkak të vështirësive financiare të përmbledhura më lartë, NQ Gjakova në vazhdimsi ka pranuar subvencione nga buxheti i Kosovës, të cilat kanë ndikuar gjer në një masë në rritjen e aftësisë financiare për të paguar për koston e mazutit.

Si ilustrim është dhënë subvencioni për sezonin 2013/2014 që ka qenë në vlerë prej 500,000 €. Nga kjo vlerë ishte paraparë që shuma e mbetur prej rreth 200,000 € të shfrytëzohet në pjesën e parë të sezonit 2014/2015 gjegjësisht për periudhën 15 tetor – 31 dhejtor të viti kalendarik 2014. Mirëpo për shkak të borxheve ndaj furnitorëve të mbetura nga periudhat e kaluara, kjo shumë është marrë sipas vendimeve gjyqësore dhe të procedurave përkatëse përmbartimore.

Për këtë NQ Gjakovës i është premtuar rialokim i subvencioneve përmes rishqyrtimit të rregullt të buxhetit i cili nuk realizuar. Gjithashtu, për shkak të rrethanave në lidhje me konstituimin e institucioneve, nuk ka pasur ndonjë indikacion të sigurt për shumën e subvencioneve nga buxheti i Kosovës në vitin kalendarik 2015. Duhet theksuar se nga Komuna nuk është marrë as premtuar ndonjë subvencion.

Në këtë situatë, asnjë vlerësim i bazuar nuk ka mundur të bëhet për shumën e subvencioneve për sezonin 2014/2015. Duke ditur se subvencionet kanë një pjesmarrje të madhe në mbulimin e kostove, dhe nisur nga qasja që konsumatorët të mos ngarkohen për kostot që janë mbuluar nga subvencioni, gjatë përcaktimit të të Hyrave të lejuara shuma e subvencionit është zbritur. Për këtë shkak mungesa e ndonjë indikacioni pak a shumë të



sigurt për vlerën e subvencionit, e bën parashikimin për subvencion mjaft të diskutueshëm, dhe me ndikim mjaft negativ nëse gabohet në këtë parashikim.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë mund të përfundohet se performaca e dobët operuese dhe financiare, si dhe paqartësitë rreth subvencioneve, janë faktorët kyq të cilët kanë penguar për të kryer parashikimet reale të nevojshme për aplikim tarifor të kompletuar.